



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:070958

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05630481

KF.nr.371/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit NSH “Elektor Servis Prishtina”, me numër unik identifikues 810938110 dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Kërveshi & Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e aktvendimit, me objekt kontesti kundërvajtje doganore, vlera e kontestit 1,116.50 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 17.04.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse avokat Gent Spahija dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur M.K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpapia e paditësit NSH “Elektro Servis Prishtina” me numër unik identifikues 810938110 dhe seli në Prishtinë, , si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.07.3/857/17 GR i datës 08.03.2021 i Doganës së Kosovës.
- III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit NSH “Elektro Servis Prishtina” me seli në Prishtinë, t’ia kthej mallin e konfiskuar në vlerë prej 1,116.50 €, me qëllim të zhdoganimit në procedurë të rregullt doganor në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 16.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit nr.07.3/857/17 GR i datës 08.03.2021. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat materiale të dorëzuara në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohet se paditësi ka qenë porositës i mallit, ndërsa personi i cili është shpallë përgjegjës për kundërvajtje doganore Sh.B. ka qenë vetëm transportuese i mallit. Më tej ka theksuar se paditësi nuk mund të mbahet përgjegjës për veprime të transportuesit të mallit dhe i njëjti nga provat materiale dhe ankesa e paraqitur në doganë, vërtetohet fakti se ka qenë i gatshëm për ta paguar për zhdoganimin e mallit në këmbim të marrjes së mallit, mirëpo kjo gjë i është pamundësuar për shkak të veprimeve të kundërligjshëm të paditurës ku e njëjta thekson se ky mall është konfiskuar dhe nuk mund ti kthehet paditësit. Lidhur me kundërshtimin e të paditurës se nuk kanë disponuar me faturën 9486, sqaron se në faqen e parë të procesverbalit mbi kundërvajtjen doganore tek pjesa e përshkrimit të rastit vërtetohet saktësisht se faturat me nr. 9446 me vlerë 863.07 euro dhe fatura me nr. 9486 me vlerës 253.43 euro dhe se ky procesverbal është i nënshkruar prej katër zyrtarëve doganorë. Nga gjykata ka kërkuar që të zbatohet dispozitën e nenit 286 të KDA-së në të cilën përcaktohet se Dogana mund t'ia kthej mallin pronarit apo kryerësit të shkeljes administrative doganore sipas kërkesës me kusht që paditësi i kërkesës të paguajë vlerën e mallit dhe detyrimet importuese/eksportues. Gjykatës i ka propozuar që të vendos si në petitumin të padisë.

E paditura në përgjigje në padi të datës 09.03.2022 ka deklaruar se e konteston në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe se aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilin pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetim se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provës të vetme. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Dogana e Kosovës gjatë gjithë kohës ka udhëhequr fillimisht iniciimin e procedurës së kundërvajtjes, shqiptimin e gjobës dhe konfiskimin me aktvendim të kundërvajtjes dhe gjithashtu në fazën e ri shqyrtimit ka sjellë aktvendim tërësisht të bazuar në ligj dhe pretendimet të paditësit, dhe se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk mund të vërtetohet me asnjë provë të vetme. Ka theksuar se duke i trajtuar vërejtjet e gjykatës në ri procedurë Dogana e Kosovës ka sqaruar edhe një herë paditësin se në rastin konkret gjatë importit të mallit nga personi Sh.B. janë përmbushur të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse të paraparë në nenin 276 pika a ku thuhet se malli i cili nuk deklarohet në hyrje i nënshtrohet

konfiskimit dhe gjithashtu një gjobë të caktuar të cilën ia ka shqiptuar dogana. Ka shtuar se Dogana nuk mund të ndikoj në raportin e transportuesit siç pretendon paditësi sepse ajo është një marrëdhënie juridike e rregulluar në mes tyre dhe e njëjta mund të zgjidhet në një procedurë civile lidhur me kompensim të dëmit të shkaktuar nga pala e tretë, ndërsa për doganën nuk është kontestues se malli nuk është deklaruar dhe se janë përmbushur kushtet për shqiptimin e kundërvajtjes doganore siç u cek më lartë. Tutje ka shtuar se Lidhur me dorëzimin e faturës nr.9486 është një provë e re e cila nuk është administruar as në Doganë e as në vendimin e Gjykatës Themelore. Gjithashtu konsideron se nëse ky dokument ka ekzistuar nga fillimi është dokument bazë i cili është dashur të shoqëroj mallin qysh në ditën e hyrjes së mallit në kufi. Gjykatës i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit dhe të lë në fuqi aktvendimin kontestues.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 11.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 07.3/857/17 i datës 08.03.2021, Ankesë e paditësit e datës 17.11.2017, Procesverbal mbi kundërvajtjen doganore i datës 12.11.2017, Aktvendim 03.1.7-2017-1169 i datës 14.11.2017, Listë distribuimi e datës 17.11.2017, Letër informative e datës 04.12.2017, Aktvendimi 01.3.2.2/857 i datës 12.12.2018, Aktgjykim A.nr. 244/18, Email i datës 20.12.2017, Faturë nr. 9446 e datës 24.10.2017, Deklaratë eksportuese, Ankesa e datës 16.02.2018, Faturë 9486 e datës 25.10.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se Sektori për Kundërvajtje në Prishtinë me aktvendim Nr.03.1.7-2017-1169 i datës 14.11.2017 kishte gjobitur Sh.B. dhe e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore duke shqiptuar gjobë administrative në shumë prej 600.00 € si dhe i ka konfiskuar mallin lëndor sipas procesit mbi kundërvajtjen doganore në vlerë prej 1.116.50 €. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se subjekti ankimor ka ushtruar ankesë si palë e

dëmtuar. Subjekti ankimor, këtu paditësi si pronarë mallit të konfiskuar, duke qenë i pakënaqur me vendimet e Sektorit të Rishqyrtimit të Vendimeve kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore Prishtinë, e cila me aktgjykimin A.nr. 244/18 datës 02.11.2020 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Dogana e Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.244/18 ka nxjerr aktvendimin nr.07.3/857/17 të datës 08.03.2021 me të cilën e ka refuzuar si të pabazë kërkesën nr.01.3.2.2-857/18.12.2017. Kundër këtij vendimi paditësi me datë 16.04.2021 ka paraqitur padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, e cila pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ka kaluar në kompetencë të kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i aktvendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës me datë 08.03.2021, duke vepruar në rivendosje ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.7-2017-1169 të datës 14.11.2017, me arsyetim se Sektori i Kundërvajtjeve Doganore ka vepruar drejtë kur subjektin e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore në shumën prej 600.00 €, si dhe kur ka konfiskuar mallin lëndor pjesë të reja për lavatriqe me vlerë 1,116.50 €, pasi që procedura kundërvajtjese kundër tij është iniciuar nga pikë kalimi kufitar Vërmicë me anë të procesverbalit nr.03.1.7-2017-1169 të datës 14.11.2017, për shkak se me datë 12.11.2017 rreth orës 10:00 në autobusin e kompanisë “Kodra e Tours” kontrollës doganore nuk i ka prezantuar mallin “pjesë për lavatriqe nga Italia” sipas faturës së mallit në vlerë prej 1,116.50 € me ç ‘rast subjekti kishte kryer kundërvajtje doganore sipas nenit 276 paragrafi a) të Kodit Doganor. Tutje ka theksuar se pas fazës së trajtimit të kësaj lënde kundërvajtjese si person i tretë i dëmtuar është paraqitur subjekti në procedurë “Elektro Servis Prishtina” me pretendim se malli lëndor ka qenë i tij dhe se personi Sh.B. ka qenë vetëm transportues i mallit dhe se i njëjti posedon dokumentacionin si faturë e mallit, deklarata eksportuese. Më tej ka shtuar se Dogana e Kosovës pas marrjes në vlerësim të vërejtjes të Gjykatës që subjektit të i njihet e drejta (legjitimiteti) si palë e dëmtuar, në rastin konkret Dogana ia njeh këtë të drejtë, mirëpo Dogana erdhi në përfundim se ndaj personit Sh.B. është shqiptuar gjobë administrative pasi tek i njëjti është gjetur malli lëndor, njëherë ai mall është konfiskuar ngase ishte shkelur dispozita e nenit 276 pika a) KDA-së në kuptim, në këtë kuptim apo lidhur me pretendimin e subjektit se duke qenë se ky është pronar i mallit dhe të njëjti i lejohet blerja e tij, Dogana e Kosovës në vendimin kontestues ka cekur se dispozitat e nenit 276 pika a) lidhet me mos paraqitjen e mallrave për zhdoganim jo me personat qofshin posedues apo pronar, prandaj Dogana nuk mund të vërtetojë tjetër gjendej faktike nga ajo çka ka ndodhur, nuk mund

të veproj me supozimin se si do të ishte sjellë pronari i mallit në raport me paraqitjen apo mos paraqitjen e mallit pran autoriteteve doganore.

Gjykata konstaton, se nga kjo gjendje faktike, Dogana e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me Kodin Doganor të Kosovës duke shkelur nenin 284 paragrafi 2 ku parashihet se *“Malli që është objekt i shkeljes administrative doganore, për të cilin është paraparë konfiskimi i mallit, do të ndalet deri në përfundimin e procedurës kundërvajtjese”*. Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore e refuzon kërkesën e paditësit për kthimin e mallit të konfiskuar, pasi që kërkesa e paditësit është plotësisht e bazuar dhe e paraparë në dispozitën e nenit 286 të Kodi Doganor ku parashihet se *“Mallin e konfiskuar në procedurën e shkeljes administrative, Dogana mund t'ia kthej pronarit apo kryerësit të shkeljes administrative doganore, sipas kërkesës në qoftë se është fjala për mallin, për të cilin janë plotësuar kushte e importit dhe me kusht që paraqitësi i kërkesës paguan vlerën e mallit dhe detyrimin importues/eksportues”*.

Nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se këtu paditësi kishte paraqitur dokumentet mbështetëse dhe atë deklaratën eksportuese, faturat e mallit, CMR me të cilën dëshmohet se malli i përket paditësit. Po ashtu gjykata konstaton se paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesë të zhdoganimit të mallit dhe pagesës së vlerës së detyrimit për mallin importuese, megjithatë e paditura nuk e kishte trajtuar kërkesën e të njëjtit.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm.

Rrjedhimisht, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b) të KDAK-së Nr.03/L-109, dhe nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi aktvendimin nr.07.3/857/17 të Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe e obligon të paditurën Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit NSH “Elektro Servis Prishtina”, t’ia kthejë mallin e konfiskuar në vlerë prej 1,116.50 € me qëllim të zhdoganimit në procedurë të rregullt doganore, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marr konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.371/22, datë 17.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.